



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Procur - Pribil/ku/ID/Date	01-03-2022	Procur
Titulli i aktit (titulli)		Kategoria
		Vlera

01-110/05-216



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 40, paragrafi 2, shkronja e dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Udhezimin Administrativ MAPL-05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen e kompotencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 36 shkronja d, neni 40, 47 shkronja e të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Liritë, të Drejtatë e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komitetit për Liritë, të Drejtatë e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komiteti për Liritë, të Drejtatë e Njeriut dhe Barazi Gjinore ka këtë përbërje:

1. Arbnora Hajredini-Elez- anëtare e kuvendit;
2. Lindita Demelezi anëtare e kuvendit;
3. Veton Ramadani anëtar i kuvendit;
4. Bajram Sokoli anëtar, përfaqësues nga jashtë Kuvendi Komunal;
5. Melihate Osmani anëtar, përfaqësues nga jashtë Kuvendi Komunal.

Komitetit për Liritë, të Drejtatë e Njeriut dhe Barazi Gjinore, në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti.

Neni 3

Komiteti, nga neni 1 i këtij vendimi është komitet joobligativ dhe do të shërbej si trupë ndihmës (plotësues) i Kuvendit të Komunës dhe mekanizëm rekomandues për organet komunale në fushën e lirive, të drejtatë e njeriut dhe barazisë gjinore. Detyrat e këtij komitetit janë të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Liritë, të Drejtatë e Njeriut dhe Barazi Gjinore, të emëruar në nenin 2 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do te kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryesuesi i komitetit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të Komitetit; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi